



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK**

VENDIM

Nr. 67 datë 21.12.2022

**PËR PËRDORIMIN E FONDIT SHITESË MBI FONDIN E KUSHTËZUAR PËR
NDIHMËN EKONOMIKE (DERI NË 6 %), PËR MUAJIN NENTOR 2022**

Këshilli Bashkiak Shkodër, në mbledhjen e tij të datës 21.12.2022, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, bazuar në Ligjin 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, Ligjin nr. 57/2019 "Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë", VKM nr. 597 datë 04.09.2019 " Përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike", i ndryshuar, Vendimin Nr. 868, datë 29.12.2021 "Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 597, datë 4.9.2019, të Këshillit të Ministrave, Udhëzimin Nr. 4, datë 17.02.2017 "Për Përlllogaritjen e Përfitimit të Ndihmës Ekonomike", Udhëzimin nr. 5, datë 17.02.2017 " Mbi përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike deri në 6 për qind.", Udhëzimin nr.1, datë 02.02.2015 "Mbi zbatimin e vendimit nr 8 datë 14.1.2015 të Këshillit të Ministrave për mbrojtjen e shtresave në nevojë nga heqja e fashës deri 300 kwh për faturimin e cmimit të energjisë elektrike" i ndryshuar, Shkresën nr. 69/99 prot. dt. 27.10.2022 të Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shkodër për akordimin e fondeve limit për muajt Nëntor-Dhjetor 2022, si dhe relacionin e përgatitur nga administrata e Bashkisë Shkodër:

V E N D O S I:

1.Për përdorimin e fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike (deri në 6 për qind), fondi i miratuar nga Drejtoria Rajonale për muajin Nëntor (12,995,759) lekë, dhe përzgjedhjen e familjeve në nevojë, 195 familje që do të trajtohen me shumën (779,528) lekë për muajin Nëntor 2022, sipas listës bashkëngjitur.

2.Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.

3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar.

KRYETAR


Brisela **KADIJA**



Sekretari i Këshillit Bashkiak



Denis Lesha

Miratuar me 29 vota

Vota Pro 29

Vota Kunder 0

Vota Abstenim 0

Zbardhur me datë 22.12.2022